

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Joint Stock Companies
Trepça Deonëarsko Društvo

Nr. 8311 Data 08.10.2025
Mitrovicë Mitrovica



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deonëarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Në bazë të Ligjit nr.03/L-212 të Punës neni 8 dhe neni 10 paragrafi 2 nëparagrafi 2.2, neni 22 paragrafi 4 i Statutit të Trepça Sh.A., neni 8 paragrafi 2 të Rregullores për Marrëdhënie pune në Trepça Sh.A., si dhe bazuar në Rregulloren nr. 4249 të datës 03.08.2023 për Sistematizimin e Vendeve të Punës në Njësinë Biznesore Minierat me Flotacion Kishnicë dhe Artanë, Trepça Sh.A me datë 08.10.2025 publikon këtë:

KONKURS

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Titulli i pozitës së punës:	Punëtor në Minierë
Koeficienti/Paga	640€ bruto
Nr. i kërkuar	5
Kohëzgjatja e emërimit	Në periudhë të caktuar (1 vjeçare me mundësi vazhdimi, puna provuese 6 muaj)
Data e njoftimit	08/10/2025
Afati për aplikim	09/10/2025-23/10/2025
Institucioni	Ndërmarrja "Trepça Sh.A."
Njësia Biznesore	Minierat me Flotacion Kishnicë dhe Artanë
Vendi i punës	Artanë

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

- Orarin e punës e merr nga mbikëqyrësi i turnit;
- Punon në ngarkimin e xehes në vagoneta apo mbushjen e tyre nga pinat e xehës;
- Përcjell çdo herë lokomotivën me vagoneta të mbushur apo të zbrazët dhe për çdo ndryshim apo anomali sinjalizon lokomotivistin;
- Për punën e vet i përgjigjet lokomotivistit dhe mbikëqyrësit të turnit;
- Punon edhe punë të tjera sipas urdhërit të udhëheqësit, të cilit drejtpërdrejtë është përgjegjës për punën e tij;
- KUSHTET: II/ punëtor i gjysum i kualifikuar në minierë.

2. Kriteret e përgjithshme

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një vepre penale;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës.

3. Kriteret e veçanta

- Të posedojë minimalisht diplomë të shkollimit të mesëm të ulët;
- Duhet të ketë së paku gjashtë (6) muaj përvojë; (Minimalisht të ketë kryer punën praktike) – punë praktike në minierë.

4. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit

- Aplikacioni (i cili shkarkohet online nga ueb-faqja e Trepça Sh.A.);
- Deklarata nën betim (e cila shkarkohet online nga ueb-faqja e Trepça Sh.A.);
- Dëshminë e përvojës së punës profesionale;
- Dëshmi nga gjykata kompetente që dëshmon se aplikuesi nuk është i dënuar për veprë penale apo nuk është nën hetim jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj;
- CV-Biografia;
- Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës;
- Kopjet e dokumenteve mbi kualifikimin arsimor dhe / ose nostrifikimin për diplomat jashtë vendit.

5. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- a. Testimi me shkrim – 100 pikë
- b. Intervista – 300 pikë

6. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes e-mail dhe ueb faqes së ndërmarrjes “Trepça Sh.A.”

7. Mënyra e aplikimit

- Dokumentacioni duhet të dorëzohet në zyrën e protokolit të Trepça Sh.A., në Menaxhmentin e Trepça Sh.A.-Parku Industrial në Mitrovicë, çdo ditë pune nga ora 08:00-16:00.

8. Shpallja e rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesit do të shpallen përmes ueb faqes së

ndërmarrjes “Trepça Sh.A.” dhe do të njoftohen edhe në mënyrë elektronike. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Njoftim shtesë: Kandidatët e pranuar për një periudhë 5 vjeçare nuk mund të transferohen apo të sistemohen në pozita jashtë minierës.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.

Trepça Sh.A.

Kryeshefi Ekzekutiv



Faton Ahmeti